

VENDIM
Nr. 115, datë 13.3.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN

NR. 546, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE SHTESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA, TË ATASHEVE USHTARAKË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PERSONELIT CIVIL TË MINISTRISË SË MBROJTJES QË SHËRBEJNË NË PËRFAQËSITË USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË NATO-s, NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE NË SHTABET USHTARAKE NDËRKOMBËTARE, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI NËPUNËS NDËRLIDHËS PRANË QENDRËS SECI, TË PUNONJËSVE SHQIPTARË PËR KOHËN QË SHËRBEJNË SI OFICERË KONTAKTI, PRANË MINISTRIVE TË BRENDSHME HOMOLOGE TË SHTETEVE TË NDRYSHME TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9210, datë 12.2.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në fund të titullit të vendimit shtohen fjalët “... dhe të punonjësve të sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural për kohën që shërbejnë si përfaqësues të kësaj ministrie pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel ...”.

b) Në fund të pikës 1/4 shtohen fjalët “... dhe punonjësit e sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural për kohën që shërbejnë si përfaqësues të kësaj ministrie pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel ...”.

c) Në kolonën “Pozicioni”, të lidhjes nr. 4, që përmendet në pikën 5, pas emërimit “oficer kontakti”, shtohet emërtimi “përfaqësues të sekretariatit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të fillojnë nga momenti i emërimit të punonjësve në detyrë dhe të përballohen nga fondet e miratuara për sistemin e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama